



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2023:187682
Datë: 21.06.2024
Numri i dokumentit: 05846390

Pml.nr.369/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Rasim Rasimi, kryetar, Agim Maliqi dhe Afrim Shala, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit H. K., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 dhe 1 të Kodit Penal të Republikës (KPRK), duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit, kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm P.nr.720/2023 të datës 22.12.2023 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës- Departamenti i Përgjithshëm PA1.nr.195/2024 të datës 22.04.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 19 qershor 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit H. K., anulohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm PA1.nr. 195/2024 të datës 22.04.2024 dhe çështja i kthehet gjykatës së njëjtë në rigjykim.

A r s y e t i m

Vendimi i Gjykatës Themelore

Gjykata Themelore në Gjiilan - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin *P.nr.720/2023 e datës 22.12.2023*, të dënuarin H. K. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së duke e gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 140 (njëqindekatërdhjetë) ditëve dhe i cili dënim me pëlqimin e tij i është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej 2500 (dymijepesëqind) €. I dënuari është obliguar në pagesën e shumës prej 200 €, në emër të shpenzimeve të procedurës penale, shumën prej 30 €, në emër të paushallit gjyqësor dhe shumën prej 50 € në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit, kurse të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin PA1.nr.195/2024 e datës 22.04.2024, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kundër këtyre aktgjytimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit H. K., avokati Prek Kola nga Gj., për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të anuloj aktgjykimet e kundërshtuara dhe çështjen të e kthej në rigjykim në gjykatën e shkallës së dytë.

Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.210/2024 e datës 13.06.2024 ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të aprovohet si e bazuar.

Pretendimet e paraqitura në kërkesë

Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit thekson se gjykata e shkallës së dytë ka bërë shkelje procedurale duke nxjerrë aktgjykim pa e caktuar fare seancën e kolegjit dhe paraparakisht duke mos e njoftuar të dënuarin dhe mbrojtësin e tij që të marrin pjesë në seancë me qëllim të paraqitjes së pretendimeve të tyre me rastin e shqyrtimit të ankesës e që pretendohet se me këtë rast është mohuar e drejta për paraqitjen e rrethanave lehtësuese me rastin e matjes së *dënim*. Kjo duke

marrë parasysh faktin se në ndërkohë kanë ndryshuar rrethanat lehtësuese në favor të të dënuarit pasi që në ndërkohë ka arritur moshën e pensionimit dhe kjo rrethanë do të duhej të ndikonte në matjen e dënimit.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

- kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar.

Duke vlerësuar pretendimet përkitazi me mos caktimin e seancës së kolegjit, Gjykata Supreme e Kosovës *vëren faktin se* duke u bazuar në dispozitën e nenit 390 të KPP-së është përcaktuar se: *“Kur të akuzuarit i është shqiptuar dënim me burgim apo kur ka pretendime që shtrohen për shqyrtim të fakteve dhe ligjit për të bërë vlerësim lidhur me fajësinë apo pafajësinë, njoftimi për seancën e kolegjit i dërgohet, Prokurorit të Apelit, të dëmtuarit dhe mbrojtësit të tij apo përfaqësuesit të viktimave, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij.”.*

Ashtu që duke u referuar në dispozitën përkatëse del se në rastin konkret nuk ka qenë e domosdoshme njoftimi për seancën e kolegjit, pasi që kushtet për një njoftim të tillë janë vetëm në rastet e përcaktuara në mënyrë taksative dhe atë në rastet kur është shqiptuar dënim me burgim apo kur ka pretendime që shtjellohen faktet apo ligji lidhur me vlerësimin e fajësisë apo pa fajësisë. Kurse në rastin konkret asnjëri prej këtyre kushteve nuk ishte plotësuar, meqë të dënuarit i ishte shqiptuar dënim me burgim por i cili është zëvendësuar me dënim me gjobë dhe atë me pëlqimin e tij, kurse bazuar në ankesën e paraqitur nuk ka pasur pretendime për shqyrtim të fakteve dhe ligjit përkitazi me fajësinë apo pafajësinë e të dënuarit, meqë i dënuari gjatë shqyrtimit fillestar kishte bërë pranimin e fajësisë duke mos kontestuar as faktet dhe as ligjin. Kurse ankesa ishte parashtruar vetëm përkitazi me vendimin lidhur me sanksionin penal, përkatësisht lartësinë e dënimit, andaj edhe njoftimi lidhur me seancën e kolegjit e bën jo të detyrueshme në kuptim të dispozitës ligjore të lartë cituar.

Mirëpo duke u bazuar në shkresat e kësaj lënde del se gjykata e shkallës së dytë nuk ka shqyrtuar fare ankesën e të dënuarit H. K. e cila ankesë ishte paraqitur gjithashtu vetëm përkitazi

me vendimin për sanksionin penal. Andaj, duke pasur parasysh dispozitën e nenit 398 par.3 të KPP-së se gjykata e shkallës së dytë vendosë për të gjitha ankesat e paraqitura në të njëjtin aktgjykim, atëherë se me këtë rast kjo gjykatë kishte shkelur këtë dispozitë ligjore duke anashkaluar në tërësi ankesën e të dënuarit. Për më tepër, del se mos trajtimi i kësaj ankese të jetë shkelje e natyrës kushtetuese dhe gjithashtu cenim i të drejtave të garantuara sipas KELDNJ të cilat gjejnë zbatim të drejtpërdrejtë në vendin tonë.

Në rigjykim, Gjykata e Apelit duhet të evitojë shkeljet e konstatuara më lartë posaçërisht të trajtoj edhe një herë ankesat e paraqitura e më pas të merr një vendim të drejtë dhe të ligjshëm duke pasur parasysh edhe pretendimet e paraqitura në kërkesa.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 438 par.1 pika 1.2 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.369/2024, më 19 qershor 2024

B.profesional,
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,
Rasim Rasimi